



## MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

---

### DIREKTIVA E MBROJTJES 2023

## Hyrje

Pandemia e Covid-19, me të cilën bota u përball për rreth dy vjet, si edhe agresioni i armatosur dhe i pajustifikuar i Ruseve ndaj Ukrainës dhe popullit të saj të pafajshëm, kanë ndryshuar në mënyrë drastike mjedisin e sigurisë dhe perceptimin e tij te qytetarët. Është e qartë se sot përballemi me sfida serioze reale, të cilat pak kohë më parë i kemi trajtuar si skenarë studimi.

Agresioni rus mbi Ukrainën, kriza ekonomike që pasoi atë, frika e vijueshme e një precipitimi të situatës drejt përhapjes së konfliktit apo dhe drejt përdorimit të armëve bërthamore, tronditi qetësinë e Evropës dhe të gjithë botës, duke shënuar kështu hyrjen në një “epokë të re”, në kontekstin e mbrojtjes dhe sigurisë.

Sigurisht, çfarë ndodh në kufijtë lindorë të Aleancës reflektohet edhe në rajonin e Ballkanit, ku ndasitë etnike, demokracitë e pakonsoliduara, krizat politike, influencat malinje të shteteve të caktuara dhe vendeve të tyre “proxy” mund të konsiderohen faktorë të rëndësishëm për destabilizim dhe krijim konfliktesh.

E ndërsa konfliktet e armatosura rishfaqen pas shumë kohësh në kufijtë e BE-së, kërcënime të reja ndaj sigurisë tashmë janë materializuar, duke përfshirë sulmet kibernetike, kërcënimet hibrider, terrorizmin, dezinformimin, ndryshimet klimatike, krizën ekonomike dhe atë të energjisë apo edhe inteligjencën artificiale.

Në një mëdis sigurie gjithnjë e më të vështirë për t'u mbajtur solid, detyrimisht ndërveprimi me vendet partnere për parandalim, frenim dhe vënien në kontroll të situatave dhe faktorëve që rrezikojnë paqen dhe sigurinë e qytetarëve shqiptarë, mund të konsiderohet dhe është detyrë primare. Qytetarët shqiptarë meritojnë të jetojnë në një mëdis të sigurt dhe të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbajnë një përgjegjësi të madhe, përgjegjësinë për të garantuar dhe siguruar një mëdis të qetë dhe të sigurt për gjithkënd.

Gjatë vitit 2022 Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura treguan një nivel të lartë përgjegjshmërie dhe profesionalizmi. Pati zhvillime të rëndësishme financiare dhe ligjore, që lidhen drejtpërdrejt me trajtimin e personelin ushtarak, duke filluar nga rritja në një masë të konsiderueshme të pagave të tyre te një trajtim më gjithëpërfshirës financier dhe logistik për personelin civil dhe ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura. Progres të rëndësishëm bëmë këtë vit edhe në fushën e modernizimin me zgjerimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura, duke nisur me shtimin e mjeteve ajrore, si dhe rritjen e aftësive zbuluese në hapësirën detare dhe ajrore.

Për vitin 2023 sfidat dhe angazhimet tona do të vazhdojnë të janë në të njëjtë intensitet, por pa iu shmangur detyrës tonë kryesore, atë të mbrojtjes së Atdheut. Do të vijojmë të ndjekim me përparrësi absolute angazhimin tonë si një vend anëtar i NATO-s, duke kontribuar në misionet e saj në mbrojtje të sigurisë euroatlantike, si dhe duke vazhduar prezencën në misionet e OKB-së dhe BE-së. Pjesë e rëndësishme, gjithashtu, e misionit dhe detyrave të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë përgjigja kombëtare dhe kontributi përherë i vyer në mbështetje të popullatës civile, në rastet e mundshme të fatkeqësive natyrore apo emergjencave të tjera civile.

Shpreh bindjen se strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura do të realizojnë me sukses objektivat, duke dhënë kontributin më maksimal në jetësimin e tyre.

Niko Peleshi  
Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë

## FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË PËR VITIN 2023

### 1. Kuadri konceptual në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Të vazhdohet procesi i rishikimit të Strategjisë Ushtarake dhe si rrjedhojë të harmonizohet dhe plotësohet Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura (FA) 2023-2031, i cili duhet të përcaktojë, veç të tjerash, strukturën e ardhshme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH).

Procesi i planifikimit dhe hartimit të planeve kombëtare të mbrojtjes rekomandohet të jetë në harmoni dhe ndërveprim të plotë me atë të Aleancës, si edhe do të reflektojë Konceptin e Ri Strategjik të NATO-s 2022, Modelin e Ri të Forcës dhe të bazohet në projekzionet e ndryshme që ka realiteti aktual i sigurisë.

Plani i Integritetit 2022-2025, si dokumenti i parë i hartuar nga Ministria e Mbrojtjes, për të kontribuar në parandalimin dhe luftën kundër korruptionit, të shtrihet në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së dhe strukturat vartëse, si dhe të shërbejë edhe si mekanizëm për orientimin e masave për forcimin e integritetit dhe adresimin e rreziqeve që sjell fenomeni i korruptionit.

### 2. Mirëmenaxhimi dhe zhvillimi i burimeve të mbrojtjes.

#### ➤ Burimet njerëzore, rekrutimi, promovimi:

Materializimi i rritjes së pagës në nivelin 30% për personelin ushtarak të FARSH-it, si dhe premtimi për një rritje të dytë për vitin 2023 janë një zhvillim tejet pozitiv me ndikim të gjerë në jetën e përditshme të ushtarakëve. Kjo rritje, e kombinuar edhe me përmirësimin e ndjeshëm të infrastrukturës ushtarake, besojmë dhe shpresojmë se do të ketë ndikim akoma edhe më pozitiv në radhët e të rinjve, të cilët vlerësojnë ta projektojnë të ardhmen e tyre në radhët e FA-së.

Kualifikimi dhe arsimimi i personelit do të mbështetet në programet më bashkëkohore që zhvillohen në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA), Kolegin e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Gjatë vitit 2023 do të vijojnë praktikat për ridislokimin e plotë të zyrave të seksioneve të rekrutimit në qendër të qytetit, mundësish pranë bashkive. Rekrutimi do ta vendosë kandidatin në qendër të procesit, duke garantuar trajtimin me dinjitet të tij në çdo hallkë të përzgjedhjes, gjë që i ndihmon Forcat e Armatosura të arrijnë cilësinë dhe sasinë e duhur në rekrutim.

Një përzgjedhje optimale për kushtet e shoqërisë sonë arrihet duke transformuar sistemet tradicionale të rekrutimit, duke përdorur shembuj të praktikave më të mira të historisë dhe trashëgimisë së pasur të FARSH-it, si dhe duke kryer një analizë specifike, paraprake, bazuar në zhvillimet social-demografike në vend.

#### ➤ Arsimimi, trajnimi dhe stërvitja:

Do të vijojë transformimi i sistemit të Arsimit të Lartë Ushtarak (ALU), si pjesë integrale e arsimit të lartë kombëtar.

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), si strukturë e sapokrijuar, nëpërmjet kurseve do të përgatisë komandantët dhe drejtuesit e ardhshëm në të gjitha nivelet, si edhe oficerë të aftë të punojnë e ndërveprojnë në shtabet dhe strukturat operacionale të NATO-s. Në këtë drejtim KMS-ja do të vijojë punën për unifikimin programor për gjithë kurset e kualifikimit për oficerët, nga niveli bazë deri në kursin më të lartë.

Konsolidimi i Qendrës së Inovacionit do të jetë në fokus të AFA-së. Kjo qendër e pajis institucionin me teknologjinë dhe infrastrukturën e nevojshme laboratorike, duke synuar kështu krijimin e një mjeti mbështetës për procesin e kërkimit shkencor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Stërvitja do të ngelet prioritet për përbushjen e misionit kushtetues të FA-së, niveli të ambicies dhe të angazhimeve në misionet dhe operacionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Zhvillimet e fundit kanë përcaktuar domosdoshmérinë e një transformimi dhe reformimi të procesit dhe mënyrës së stërvitjes. Operacionet luftarake, skemat e manovrave, si dhe kundërpërgjigja e Ukrainës duhet të na shërbejnë për të identifikuar mësimë të vlefshme, me qëllim që të “stërvitemi si për të luftuar”, duke prodhuar rezultate edhe nën një forcë presioni të madh.

Fokusi kryesor gjatë vitit 2023 do të jetë organizimi, kompletimi dhe realizimi i komandim-kontrollit të Brigadës Shumëkombëske Task Force South, për pjesëmarrjen në stërvitjen “Defender Europe 23”.

#### ➤ **Burimet materiale:**

Vijimi i investimeve në fushën e infrastrukturës me synim përmirësimin e kushteve të punës, jetesës e stërvitjes së personelit të FA-së dhe rritjen e sigurisë në ruajtjen e materialeve ushtarake vlerësohet si proces i një rëndësie të veçantë.

Synohet përmirësimi i kapaciteteve dhe kontributeve kombëtare të mbështetjes logistike për mbështetjen e trupave që angazhohen në misione/operacione jashtë vendit në kuadër të NATO-s ose koalicioneve të tjera, nëpërmjet sigurimit të transportit strategjik (ajror, detar, tokësor dhe i kombinuar), për dislokimin dhe ridislokimin e trupave, ngritjes dhe testimit të Elementit të Mbështetjes Kombëtare (NSE) dhe përdorimit të programit të NATO-s “LOGFAS”, për planëzimin dhe ekzekutimin e mbështetjes logistike.

Do të punohet me riorganizimin e kapaciteteve të riparimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve tokësore, duke u fokusuar në të gjitha elementet e saj dhe bazuar në elementet funksionale të “DOTMILPFI”, si edhe me Testimin e Programit të Automatizuar të Logistikës (PAL), për menaxhimin e materialeve në inventar të FA-së.

#### ➤ **Burimet financiare:**

Disiplinimi me përgjegjshmëri i buxhetit vjetor të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe respektimi i kërkesave buxhetore dhe mbështetja e programeve të Mbrojtjes, duhet tëjenë kushtet thelbësore të cilat do të na mundësojnë opsione të favorshme në fushën e mbrojtjes. Synimi kryesor të jetë zhvillimi i kapaciteteve, në kuadër të modernizimit të FA-së dhe angazhimeve ndërkombëtare.

Buxheti të realizohet në përputhje me objektivat për rritje të transparencës dhe luftës kundër korruptionit, duke synuar rritjen e efektivitetit të shpenzimeve, si dhe vazhdimësinë e mbështetjes së projekteve të investimeve, në përbushje të prioriteteve kryesore, në kuadër të modernizimit të FA-së dhe angazhimeve ndërkombëtare.

Sigurimi dhe mbështetja me burime financiare të FA-së, duke rritur gradualisht buxhetin e Mbrojtjes, drejt kufirit 2% të GDP-së, do të jetë në fokus të angazhimeve financiare.

### **3. Mbështetja me bazë ligjore e strukturave të MM/FA-së.**

Strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat kanë kuadër ligjor të BE-së, të detyrueshëm për përafrim, do të angazhohen plotësisht për prezantimin e situatës konkrete ligjore, si pjesë e hapave proceduralë për Bilateral Screening, si dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të dala. Përvitin 2023 parësore do të jetë miratimi i projektvendimit për miratimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse.

Prioriteti tjetër në drejtim të përshtatjes ligjore do të jetë projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejimit dhe komandimit të FARSH-it”, si nevojë për ndryshim që lind si domosdoshmëri e ndryshimeve strukturore që kanë pësuar Forcat e Armatosura ndër vite. Komponenti që po jetësohet, ai i rezervistëve si një nevojë e menjëherershme, do të kërkojë me ligj edhe krijimi dhe funksionimi i strukturës organike të rezervës në terma praktikë dhe real në FARSH. Gjithashtu, në aktet ligjore për vitin 2023, nuk duhet të mungojnë edhe projektvendimet për misionet dhe operacionet në kuadër të NATO-s.

#### **4. Zhvillimi i kapaciteteve të Forcave të Armatosura.**

Zhvillimi i kapaciteteve të FARSH-it të orientohet nga përbushja e misionit kushtetues dhe mbrojtjes kolektive të Aleancës, në harmoni me Procesin e Planifikimit të Mbrotjes së NATO-s (NDPP). Fokusi do të jenë kapacitetet e deklaruara në NATO, duke ruajtur dhe konsoliduar nivelin e gatishmërisë për grup-batalionin e këmbësorissë së lehtë, si kontributi kryesor ndaj Aleancës, por edhe me *kapacite nich*, siç janë: EOD, MADM, SOLTG etj.

Mbështetja e elementeve të GBKL-së, si dhe zhvillimi i rrjeteve statike dhe të dislokueshme të sistemeve të komunikimit dhe informacionit. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet dhe përbushjes së kërkesave cilësore të Objektivave të Kapaciteteve (OK), sipas përcaktimeve dhe detyrimeve respektive nga dokumenti i NATO-s i Objektivave të Kapaciteteve (CT 2021) në planin afatshkurtër dhe atë afatmesëm.

##### **➤ Modernizimi:**

Kërcënimet nga sfidat tradicionale dhe jotradicionale të sigurisë, duhet të nxisin një vlerësim të plotë të strategjive dhe mënyrave më efikase të modernizimit, për të mundësuar vënien në dispozicion të FA-së të mjeteve të nevojshme për të ardhmen. Në praktikë është e rendësishme që modernizimi të konsiderohet si një proces shumënivelesh dhe i pandalshëm. Kjo do të vlejë jo vetëm për zinxhirin e komandim-kontrollit të FARSH-it, në nivel kombëtar, por njëkohësisht edhe në nivel ndërkombëtar, duke ruajtur me kujdes këtë dualizëm të nevojshëm.

**Forca Tokësore** do të vijojë kompletimin me mjete të blinduara, mjete taktkë, armatim dhe aksesorë për të gjithë tipat e armatimit të lehtë të këmbësorisë, kompletimin me sisteme të mbështetjes me zjarr. Objektiv do të jetë, gjithashtu, krijimi i kapaciteteve të mbrojtjes kundërtanke dhe kundërajkorre. Njëkohësisht, do të vijojnë kompletimin sistemi radar i lokalizimit të armatimit të artilerisë së kundërshtarit, sistemet e mbrojtjes së afërt ajrore me rreze të shkurtër dhe shumë të shkurtër, si dhe spitali ROL-2.

**Forca Detare** do të vijojë me modernizimin për rinvimin e sistemeve kryesore të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, zhvillimin e kapaciteteve të Qendrës së Zhytjes si kapacetet kombëtar, sigurimin e pajisjeve të komunikimit për grupin e bordingut dhe pajisjeve speciale për operacionet e ndalimit detar.

**Forca Ajrore** do të vijojë me rritjen e kapaciteteve të flotës ajrore me helikopter Blackhawk, kapacitete të mbrojtjes kundërajkorre, pajisjen me kapacitete luftarakë të papilotuara. Gjithashtu, do të ngrihet dhe do të funksionojë Qendra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Ajrore Nivel I+II+. Forca Ajrore do të ketë një angazhim të dedikuar për zbatimin e projektit të NATO-s dhe operacionalitetin e Bazën Ajrore Kuçovë.

**Komanda Mbështetëse** do të vijojë me kompletimin të kompanisë EOD me mjete speciale, si dhe vijimin e zbatimit të projektit të modernizimit me mjete transporti dhe speciale për FA-në.

### ➤ **Gatishmëria dhe Operacionaliteti:**

Të punohet për zhvillimin dhe mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve tokësore, detare, ajrore, si dhe mbështetjen logjistike në të gjitha nivelet e komandim-kontrollit (C2). Qëllimi kryesor është pjesëmarrja në operacionet e mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, reagimi me shpejtësi ndaj krizave të paparashikuara, përballimi sa më efikas i emergjencave civile/fatkeqësive natyrore.

Vijimi i përbushjes së angazhimeve të FA-së, për pjesëmarrje në operacionet ndërkontrollare si dhe plotësimi i detyrimeve në kuadër të Aleancës, në përputhje me Modelin e Ri të Forcës (NFM) dhe implementimin e konceptit të mbrojtjes dhe shkurajimit (DDA), duke sinkronizuar planet e mbrojtjes së vendit me familjen e planeve të Aleancës, vendosjen në dispozicion të Kapaciteteve Infrastrukturore dhe Logistike (KIL) të vendit si pjesë e zbatimit të këtyre planeve.

### ➤ **Ndërveprueshmëria:**

Rritja e ndërveprueshmërisë si brenda FA-së, ashtu edhe me vendet e tjera të Aleancës, do të jetë objektivi kryesor në aktivitetet stërvitore dhe zhvillimin e kapaciteteve, bazuar në konceptet dhe doktrinat e Aleancës.

Procesi i standardizimit të mbështesë planet e modernizimit të FARSH-it, duke përzgjedhur, ratifikuar dhe implementuar ata STANAG-ë që kanë ndikim në përbushjen e prioriteteve të FARSH-it, implementimin e OK-së dhe ata që konsiderohen kritikë nga Aleanca për rritjen e nivelit të ndërveprimit në misione dhe operacione të drejtuara prej saj.

## **5. Konsolidimi i Sistemit të Mbrojtjes Civile.**

Prioritet parësor është vijimi i proceseve që burojnë nga marrja e statusit të vendit anëtar në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile. Ky proces do të mundësojë forcimin e kapaciteteve dhe të standardeve të duhura në teknologji, trajnime, stërvitje dhe operacionet të përbashkëta në këtë fushë. Një rëndësi të veçantë duhet të marrë edhe praktika e komunikimit dhe ndërveprimit me qytetarët, në mënyrë që të shtrohen bazat e mirëkuptimit reciprok ndërmjet institucionit dhe popullatës civile, në rastet e fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut.

Për vitin 2023 e në vazhdim të parashikohen investime në kuadër të studimeve mbi digat e mëdha, argjinaturat e lumenjve dhe basenet ujore. Në Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë duhet të parashikohet edhe përmirësimi i legjislacionit lidhur me Sistemin e Mbrojtjes Civile, me qëllim përafrimin me legjislacionin evropian. Fillimi i punës për ligjin e ri për Infrastrukturën Kritike të konsiderohet me përparsi.

Gjithashtu, duhet të kemi një rishikim të Sistemit të Paralajmërimët të Hershëm. Duhet punuar për përmirësimin dhe modernizimin e tij me anë të projekteve të ndryshme, të cilat përfshijnë një gamë të gjerë, që nga rishikimi i ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi deri tek investimet e nevojshme për sistemin e njoftimit në kohë në popullsisë dhe strukturave, me qëllim rritjen e shpejtësisë së reagimit.

Planifikimi i rezervave të nevojshme materiale të synojë përmirësimin e burimeve kombëtare dhe ndërkontrollare, rritjen e kapaciteteve transportuese dhe magazinuese, me qëllim realizimin e ndihmës ndaj popullatës së prekur nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda.

## **6. Mbrojtja Kibernetike.**

Sulmet kibernetike vazhdojnë të rriten në frekuencë dhe kompleksitet, si dhe Mbrojtja Kibernetike është një nga pjesët më integrale të Strategjisë së Sigurisë Kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes.

Mbrojtja Kibernetike duhet të ushtrohet si një veprim i koordinuar rezistence në mbrojtje të informacionit, sistemeve dhe rrjeteve.

Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike, si një organizëm i sapoformuar, duhet të vazhdojë akoma me më shumë shpejtësi proceset e trajnimeve të operatorëve, si dhe të kapacitetave moderne në ofrimin e një shërbimi të padukshëm, por jetësor për mbrojtjen. Të vijojë zhvillimi i Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike, e pajisur me sisteme dhe trajnime bashkëkohore, e cila do t'i mundësojë operacionalitetin e pandërprerë.

## **7. Angazhimi dhe bashkëpunimi ndërkontrollor**

Koordinimi në nivel politik me partnerët tanë strategjikë dhe vendet aleate të NATO-s do të vijojë të jetë përparsi absolute për vitin 2023. Diplomacia jonë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë është e qartë dhe do të konkretizohet, si më poshtë vijon:

- Ne do të vazhdojmë të jemi kontribues në arenën ndërkontrollorare me angazhimin tonë si vend i zgjedhur jo i përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së edhe për vitin 2023. Do të punohet për shtimin e personelit pjesëmarrës të FARSH-it në OKB.
- Do të mbajmë në nivelet më të larta konsultimin diplomatik dhe ndërveprueshmërinë në këtë fushë me strukturat e Aleancës, duke u përpjekur të kemi një përfaqësim sa më dinjitoz në Samitin e Vilnusit (11-12 korrik 2023), Ministerialat e Ministrave të Mbrojtjes së NATO-s dhe takime të nivele të tjera të sferës politike.
- Tashmë, me marrjen e statusit të “vendit kandidat”, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet për vitin 2023 bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me Bashkimin Evropian, duke synuar thithjen e fondeve, implementimin e projekteve, përafrimin e legjislativit dhe plotësimin e detyrimeve në nivel kombëtar.
- Do të vijojmë të jemi partner aktiv në OSBE, duke marrë pjesë në aktivitetet vjetore të kësaj organizate, duke plotësuar raportet dhe informacionet përkatëse, si dhe duke u bërë pjesë e projekteve të reja, inspektive të armë-kontrollit etj.
- Edhe këtë vit do të përfaqësohet në ministerialat, takimet e drejtoreve politikë, takime të shefave të Shtabit dhe mbledhje të tjera të nivelit më teknik në nismat/organizatat rajonale, si: SHBA-Karta e Adriatikut (A5), Ministeriali i Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM), RACVIAC, CEDC+WB, DECI, BMTF, FNC etj.
- Bashkëpunimi në nivel dypalësh do të vijojë të jetë proaktiv dhe intensiv ndërmjet strukturave përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm me atashetë e huaj ushtarakë të akredituar në vend, si dhe me atashetë ushtarakë të Republikës së Shqipërisë në vendet aleate, me qëllim realizimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në planet dhe matricat përkatëse.
- Planet dypalëshe të bashkëpunimit, si çdo vit, do të synohen të myllen plotësisht brenda dy muajve të parë të vitit 2023.
- Shqipëria në nivel rajonal do të ndjekë edhe për vitin 2023 politikën e fqinjësisë së mirë, korrekësisë dhe bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor, duke promovuar qartë dhe fort politikën e “dyerve të hapura” në rajon. Kosova sigurisht që, edhe për vitin 2023, në rrafshin diplomatik, mbetet interes kombëtar i yni.

## **8. Komunikimi Strategjik.**

Komunikimi Strategjik të ketë për qëllim përcjelljen e mesazhit më të mirë, nëpërmjet kanaleve të duhura, kundrejt qëllimeve të mirëmduara dhe specifike, duke përdorur zhvillimin e mesazheve me nivele të larta planifikimi dhe perceptimeve të audiencës, për të bërë të njojur në mënyrë

transparente veprimtarinë e Mbrojtjes, si dhe për të ndihmuar në përbushjen e interesave strategjikë.

#### **PËRFUNDIME:**

Direktiva e Mbrojtjes 2023 do të orientojë veprimtarinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përbushjen e misionit dhe të detyrave të saj. Në zbatim të kësaj direktive, kërkoj nga të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura, të hartojnë plane, programe dhe projekte të orientuara nga prioritetet dhe drejtimet e punës, si dhe të marrin të gjitha masat për realizimin e tyre në kohë e me cilësi.